



Data: 14/08/2019

Ref.: 14 44/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 76-të të mbajtur më 25.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit Dardania për periudhën tre vjecare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022;
 - Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji Dardania ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programit të studimit të cekur në dispozitivin I. AKA ka organizuar vizitën e akreditimit në Kolegjin Dardania më datë 21.05.2019 me ekspertin ndërkombëtarë të akreditimit Milan Pol.


Sipas ekspertit ndërkombëtarë, programi i studimit i përmendur në dispozitivin I të këtij vendimi përmbush substancialisht standardet e akreditimit të përcaktuara në Manualin e Akreditimit (pesë standarde përmbush substancialisht ndërsa dy prej tyre pjesërisht) dhe rrjedhimisht ka rekomanduar ri/akreditimin e programit për kohëzgjatjen e përmendur më sipër. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 26.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Dardania dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertit ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të

dhëna në raportin final të vlerësimit nga eksperti i cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Dardania
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

